

“Under construction” - Platforma Online për konsultim publik gjatë vitit 2017

Platforma Online për konsultim publik paraqet një mjet shumë të rëndësishëm, edhe pse jo të vetëm, të zbatimit të standardeve minimale për konsultim publik. Pas një viti nga lansimi, kjo platformë ende nuk i plotëson të gjitha kërkesat e parapara me Rregullore.¹ Funkzionet bazë të regjistrimit të përdoruesëve, publikimit të Dokumenteve për Konsultim dhe postimit të komenteve janë funksionale. Megjithatë, shumë funksione të tjera të domosdoshme mungojnë, ndërsa mirëmbajtja e platformës ka qenë problematike përgjatë gjithë vitit 2017.

Për të mundësuar zbatimin e plotë të standardeve minimale të paktën në aspektin teknik, Zyra për Qeverisje të Mirë e Zyrës së Kryeministrit duhet që urgjentisht ta plotësojë Platformën Online me funksionet në vijim:

1. Funksionalizimi i plotë i mundësisë së regjistrimit të përdoruesëve të rinj duke evituar pengesat që e pamundësojnë regjistrimin;
2. Mundësimi i publikimit online të planeve të punës së Qeverisë dhe Ministrive, së bashku me mundësinë e shprehjes së interesit/abonimit për elemente të veçanta të secilit plan;
3. Mundësimi i publikimit online të takimeve publike për konsultim publik, së bashku me materialet përcjellëse përgatitore dhe raportuese;
4. Mundësimi i publikimit të verzionit të përditësuar të projektpropozimit, pas trajtimit të komenteve të pranuar gjatë konsultimit publik;
5. Automatizimi i njoftimeve të abonuesit për secilin proces të hapur të konsultimit publik, duke i'a pamundësuar shërbyesëve civil evitimin manual të dërgimit të njoftimit të palët e interesuara;
6. Emërtimi i veçantë i njoftimeve të dërguara nga Platforma Online, duke evituar emërtimin standard dhe unik pavarësisht llojit dhe përmbajtjes së njoftimit.

Edhe pse ekzistojnë metoda të shumta të konsultimit publik, më e shpeshta vazhdon të mbetet ajo e konsultimit të gjerë me shkrim. Mungesat e Platformës ndikojnë drejtpërdrejtë në suksesin e qasjes së re të konsultimit publik, sidomos në fazën e konsultimit me shkrim.

Përkundër problemeve të shfaqura, gjatë vitit 2017 Platforma Online ka mundësuar publikimin për




Figura 1: Shkalla e publikimit në Platformë Online të dokumenteve të miratuara nga Qeveria gjatë vitit 2017

¹ Neni 12 i Rregullores QRK 05/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimit publik

konsultim me shkrim të një numri domethënës të dokumenteve qeveritare. Nga 107 dokumente² të miratuara nga Qeveria gjatë vitit 2017, 36 prej tyre³ (33.6%) janë publikuar në Platformën Online për konsultim të gjerë me shkrim. Për nga lloji i dokumenteve, shkallën më të lartë të publikimit në

Platformën Online e kanë Projektregulloret me 42.9%, ndërsa më të ultën Strategjitë me 15.4%.




Figura 2: Niveli i përmbushjes së standardeve minimale për fazën e konsultimit me shkrim, gjatë vitit 2017

Raporteve Përfundimtare të Konsultimit. Vetëm gjysma e 36 proceseve që kanë kaluar konsultimin e gjerë me shkrim janë përmbyllur me një Raport Përfundimtar të Konsultimit. Në anën tjetër, për shkak që Platforma nuk e mundëson teknikisht, asnjë proces nuk e ka plotësuar obligimin e publikimit të verzionit të përditësuar, pas adresimit të komenteve të pranuar.

Nga të gjitha standardet minimale të përcaktuara me Rregullore për fazën e konsultimit të gjerë me shkrim, vetëm 10 nga 36 dokumentet e publikuara për konsultim publik i kanë plotësuar të gjitha. Përderisa shumica e dokumenteve të publikuara e plotësojnë afatin minimal dhe ekzistencën e Dokumentit për Konsultim, problemi kryesor mbetet mungesa e theksuar e

Gjatë vitit 2017, nga 36 dokumente të publikuara në Platformë, vetëm 6 dokumente janë komentuar nga palët e jashtme. Përderisa vëllimi dhe cilësia e komenteve janë përgjegjësi edhe e palëve të jashtme, parakushti themelor për të pritur shfrytëzim më të madh të Platformës Online nga publiku është informimi i të gjitha palëve për këtë mundësi. Pas ndërmarrjes së një auditimi të plotë teknik, Zyra për Qeverisje të Mirë duhet të ndërmarrë një fushatë të gjerë të informimit dhe promovimit të kësaj platforme, duke synuar rritjen e numrit të palëve të regjistruara dhe atyre që komentojnë.

Standardet minimale për konsultim publik paraqesin një mundësi të shkëlqyeshme për të rritur cilësinë dhe legjitimitetin e politikave publike, si dhe transparencën e procesit të hartimit të dokumenteve qeveritare. Suksesi i këtij sistemi të ri varet si nga përkushtimi i Qeverisë ashtu edhe angazhimi i shoqërisë civile dhe palëve të tjera të jashtme. Viti i parë dëshmon që, të paktën sa i përket Platformës Online, pa u kompletuar parakushtet e domosdoshme nga Qeveria, është vështirë të pritët kontribut i mjaftueshëm nga palët e jashtme.

KCSF përkrahet nga Suedia.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e KCSF-së dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorit.

² Projektligje, Koncept Dokumente, Strategji, Plane Veprimi, Programe, Udhëzime Administrative, Rregullore

³ Nuk përfshihen dokumentet e publikuara në Platformë, por të cilat nuk janë miratuar, si dhe Udhëzimet Administrative të publikuara në Platformë, por të miratuara në nivel të ministrive